

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
"Rentzo Sh.p.k."**



Sot më datë 08.04.2024, palet e mëposhtme:

- **Z. Vartkes Piranjani**, shtetas Shqiptar, lindur më 16 Maj 1995, banues në Rruga Sulejman Delvina, mbajtës i kartes se identitetit shqiptare, me nr. personal J50516050G;
- **Z. Mariol Karanxhe**, shtetas Shqiptar lindur më 25 Shtator 1988, me banim në Rruga Andon Zako Cajupi, mbajtës i kartes se identitetit shqiptare, me nr. personal I80925056V;
- **Z. Tedi Mara**, shtetas Shqiptar, lindur më 13 Janar 1994, me banim në Rruga Themistokli Gjermani, mbajtës i kartes se identitetit shqiptare, me nr. personal J40113041C.

të cilët kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit të mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti, së cilës i bashkëngjitet si Shtojca 1.

**Neni 1 – Emërtimi**

Shoqëria emërtohet Rentzo Sh.p.k. (në vijim "Shoqëria").

**Neni 2 – Selia**

Selia e Shoqërisë është në Rruga Nikolla Tupe, Ndertesa Nr. 88, H. 1, Kati 4, Ap. 23, Tiranë, Shqipëri.

**Neni 3 – Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar.

**Neni 4 – Objekti**

4.1 Objekti i shoqërisë do të jetë dhënia me qira pa shofer, të mjeteve të transportit, makinave, furgonëve, mjeteve të lehta dhe të rënda, motoçikletave, kamperëve, karvanëve, mjeteve lundruese për transportin e sendeve dhe personave për llogari të palëve të treta dhe për llogari të vet, në Shqipëri dhe jashtë saj; b) tregtimin, blerjen dhe shitjen e mjeteve, automjeteve, furgonëve, mjeteve të lehta dhe të rënda, motoçikletave, kamperëve, karvanëve, mjeteve lundruese dhe aksesorëve përkatës; c) realizimin dhe menaxhimin e garazheve dhe oficinave mekanike. Shoqëria mund (i) të marrë pjesë me financime ose në mënyrë operative në consortium-e edhe të përkohshme, joint venture ose (ii) të zotëroje, të blejë ose të shesë pjesëmarrje në ente, shoqëri apo ndërmarrje, edhe në fazë themelimi që kanë qëllime të ngjashme, komplementare apo gjithsesi të lidhura me të; jo si aktivitet parësor, Shoqëria mund edhe të japë garanci reale dhe/ose personale, të vendosë pengje, të dalë dorëzanëse apo të vendosë hipotekë edhe në favor të të tretëve. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme apo të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër tregtar, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues, me qëllim përmbushjen e objektit të saj, si edhe çdo aktivitet tjetër në përputhje me ligjin.

4.2. Përveç kësaj, në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion që lidhet me pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tjetër, si dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e sipërpërmendur, ose që mund



të konsiderohet i nevojshëm ose i dobishëm ose ndihmës për qëllimet e mësipërme, siç do të përcaktohet nga Shoqëria në diskrecionin e saj.

### Neni 5 – Kapitali i Shoqërisë, kontributet dhe kuotat

- 5.1 Kapitali i Shoqërisë është i barabartë me 15.001.000 (pesëmbëdhjetë milion e njëmijë) Lekë dhe është aktualisht i ndarë në 3 (tre) kuota si më poshtë. Kapitali mund të shlyhet me kontribute në para dhe/ose kontribute në natyrë.
- 5.2 Kapitali themeltar është i nënshkruar si më poshtë:
- **Z. Vartkes Piranjani**, shtetas Shqiptar, lindur më 16 Maj 1995, në Tiranë, Shqipëri, me banim në Rruga Sulejman Delvina, mbajtës i leternjoftimit me nr. personal J50516050G, zotëron një kuota, në vlerën ALL 5.000.000 (pesë milion lekë), e cila përfaqëson 33.33% (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre përqind) të kapitalit të Shoqërisë; dhe
  - **Z. Mariol Karanxhe**, shtetas Shqiptar lindur më 25 Shtator 1988, në Elbasan, Shqipëri, me banim në Rruga Andon Zako Cajupi, mbajtës i leternjoftimit me nr. personal I80925056V, zotëron një kuota, në vlerën ALL 5.000.000 (pesë milion lekë), e cila përfaqëson 33.33% (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
  - **Z. Tedi Mara**, shtetas Shqiptar, lindur më 13 Janar 1994, në Tirane, Shqipëri, me banim në Rruga Themistokli Germanji, mbajtës i leternjoftimit me nr. personal J40113041C, zotëron një kuota, në vlerën ALL 5.001.000 (pesë milion e njëmijë lekë), e cila përfaqëson 33.34% (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e katër përqind) të kapitalit të Shoqërisë.

### Neni 6 – Transferimi i kuotave

Kuotat transferohen sipas parashikimeve të Statutit.

### Neni 7 – Administrimi

- 7.1 Me këtë akt emërohet si Administrator i Shoqërisë personi si më poshtë:
- **Z. Mariol Karanxhe**, shtetas Shqiptar lindur më 25 Shtator 1988, në Elbasan, Shqipëri, me banim në Rruga Andon Zako Cajupi, mbajtës i kartes se identitetit shqiptare, me nr. personal I80925056V.
- 7.2 Administratorit i takon përfaqësimi i Shoqërisë kundrejt të tretëve, në gjykatë, dhe i takojnë kompetencat e administrimit të zakonshem të Shoqërisë në zbatim të nenit 95 të ligjit nr. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" ("Ligji Tregtar") dhe në çdo rast në përputhje dhe në kufijtë e kompetencave të përcaktuar në vendimin e emërimit dhe/ose në nenin 12 të Statutit. Në lidhje me administrimin e jashtezakonshem të Shoqërisë, Administratori mund të veprojë pasi të jete autorizuar shprehimisht nga Asambleja e Përgjithshme.
- 7.3 Administratori duhet të marrë miratim paraprak me shkrim nga Asambleja e ne lidhje me transaksione mbi 10.000 Euro.
- 7.4 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të formalitetet e përmbushjen e detyrimeve të parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.



7.5 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tyre personave të tjerë.

### Neni 8 – Regjistrimi

Me anë të këtij akti, Znj. Gerta Ylli, shtetase shqiptare, lindur më 27 qershor 1975, me banim në Tiranë, Shqipëri, me letërnjoftim nr. H55627133F, autorizohet të veprojë me qëllim regjistrimin e Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit si edhe pranë autoriteteve të tjera publike.

### Neni 9 – Gjuha

Ky Akt Themelimi është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe.

\*\*\*\*\*

### ORTAKET

Vartkes Piranjani

Vartkes Piranjani

Mariol Karanxhe

Mariol Karanxhe

Tedi Mara

Tedi Mara



**STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“RENTZO”**

Sot më datë 09.01.2024, palët e mëposhtme:

- **Z. Vartkes Piranjani**, shtetas Shqiptar, lindur më 16 Maj 1995, në Tiranë, Shqipëri, me banim në Rruga Sulejman Delvina, mbajtës i kartes se identitetit shqiptare, me nr. personal J50516050G;
- **Z. Mariol Karanxhe**, shtetas Shqiptar lindur më 25 Shtator 1988, në Elbasan, Shqipëri, me banim në Rruga Andon Zako Cajupi, mbajtës i kartes se identitetit shqiptare, me nr. personal I80925056V;
- **Z. Tedi Mara**, shtetas Shqiptar, lindur më 13 Janar 1994, në Tirane, Shqipëri, me banim në Rruga Themistokli Gjermani, mbajtës i kartes se identitetit shqiptare, me nr. personal J40113041C.

kanë vendosur të nënshkruajnë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

**KAPITULLI I  
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA DHE KOHËZGJATJA**

**Neni 1 – Forma**

- 1.1 Shoqëria “RENTZO” Sh.p.k. (në vijim “Shoqëria”) krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
- 1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar që ka karakter të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

**Neni 2 – Emërtimi i Shoqërisë**

Emërtimi i Shoqërisë është “RENTZO” Sh.p.k.

**Neni 3 – Objekti**

- 3.1 Objekti i shoqërisë do të jetë dhënia me qira pa shofer, të mjeteve të transportit, makinave, furgonëve, mjeteve të lehta dhe të rënda, motoçikletave, kamperëve, karvanëve, mjeteve lundruese për transportin e sendeve dhe personave, për llogari të palëve të treta dhe për llogari të vet, në Shqipëri dhe jashtë saj; b) tregtimin, blerjen dhe shitjen e mjeteve, automjeteve, furgonëve, mjeteve të lehta dhe të rënda, motoçikletave, kamperëve, karvanëve, mjeteve lundruese dhe aksesoreve përkatës; c) realizimin dhe menaxhimin e garazheve dhe oficinave mekanike. Shoqëria mund (i) të marrë pjesë me financime ose në mënyrë operative në consortium-e edhe të përkohshme, joint venture ose (ii) të zotëroje, të blejë ose të shesë pjesëmarrje në ente, shoqëri apo ndërmarrje, edhe në fazë themelimi që kanë qëllime të ngjashme, komplementare apo gjithsesi të lidhura me të; jo si aktivitet parësor, Shoqëria mund edhe të japë garanci reale dhe/ose personale, të vendosë pengje, të dalë dorëzanëse apo të vendosë hipotekë edhe në favor të të tretëve. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme apo të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër tregtar, industrial e financiar, të dobishëm apo plotësues, me qëllim përmbushjen e objektit të saj, si edhe çdo aktivitet tjetër në përputhje me ligjin.



3.2. Përveç kësaj, në përputhje me legjislacionin shqiptar, Shoqëria mund të kryejë çdo transaksion që lidhet me pasuritë e luajtshme ose të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tjetër, si dhe çdo veprimtari tjetër që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me objektin e sipërpërmendur, ose që mund të konsiderohet i nevojshëm ose i dobishëm ose ndihmës për qëllimet e mësipërme, siç do të përcaktohet nga Shoqëria në diskrecionin e saj.

#### Neni 4 - Selia

4.1 Selia e Shoqërisë është në adresën: Rruga Nikolla Tupe, Ndertesë Nr. 88, H. 1, Kati 4, Ap. 23, Tiranë, Shqipëri.

4.2 Shoqëria mund të hapë dhe/apo mbyllë degë, filiale dhe/ose zyra përfaqësimi, në Shqipëri dhe/apo jashtë saj, vendosur nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.

#### Neni 5 - Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

5.2 Shoqëria mund të prishet përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

### KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, RRRITJA DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

#### Neni 6 – Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është ALL 15.001.000 (pesëmbëdhjetë milion e njëmijë), i përbërë nga 3 (tre kuota). Kapitali themeltar i Shoqërisë është nënshkruar plotësisht si më poshtë vijon:

- Z. Vartkes Piranjani, shtetas Shqiptar, lindur më 16 Maj 1995, në Tiranë, Shqipëri, me banim në Rruga Sulejman Delvina, mbajtës i kartes se identitetit shqiptare, me nr. personal J50516050G, zotëron një kuota, në vlerën ALL 5.000.000 (pesë milion lekë), e cila përfaqëson 33.33% (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre përqind) të kapitalit të Shoqërisë; dhe
- Z. Mariol Karanxhe, shtetas Shqiptar lindur më 25 Shtator 1988, në Elbasan, Shqipëri, me banim në Rruga Andon Zako Cajupi, mbajtës i kartes se identitetit shqiptare, me nr. personal I80925056V, zotëron një kuota, në vlerën ALL 5.000.000 (pesë milion lekë), e cila përfaqëson 33.33% (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre përqind) të kapitalit të Shoqërisë.
- Z. Tedi Mara, shtetas Shqiptar, lindur më 13 Janar 1994, në Tirane, Shqipëri, me banim në Rruga Themistokli Germenji, mbajtës i leternjoftimit me nr. personal J40113041C, zotëron një kuota, në vlerën ALL 5.001.000 (pesë milion e njëmijë lekë), e cila përfaqëson 33.34% (tridhjetë e tre pikë tridhjetë e katër përqind) të kapitalit të Shoqërisë

#### Neni 7 – Rritja e kapitalit themeltar

7.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

7.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me kuotën e zotëruar prej tyre në kapitalin e shoqërisë. Në rast se ndonjë nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortak/ët e tjerë proporcionalisht



- 7.3 Nëse Asambleja e Përgjithshme miraton një vendim për rritje të kapitalit të Shoqërisë, Administratori/ët e Shoqërisë duhet të njoftojnë me shkrim çdo ortak ("Njoftimi i të Drejtave"). Njoftimi i të Drejtave, në përputhje me të dhënat e rritjes së kapitalit të Shoqërisë të përcaktuar në vendimin e sipërpërmendur, do të specifikojë: (1) vlerën totale shtesë të kapitalit që do të rritet; (ii) të drejtat, privilegjet, afatet dhe kushtet e rritjes së ofruar; dhe (iii) shumën e pagueshme për këtë rritje. Çdo ortak do të ketë të drejtën, e cila mund të ushtrohet brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga marrja e Njoftimit të të Drejtave, për të nënshkruar rritjen e kapitalit të përcaktuar në Njoftimin e të Drejtave në mënyrë të përvokueshme dhe në proporcion me kuotën e zotëruar në kapitalin themeltar. Nëse ndonjë ortak zgjedh të mos nënshkruajë ose të paguajë pjesën e tij në rritjen e kapitalit themeltar sipas specifikimeve të përcaktuara në Njoftimin e të Drejtave, atëherë ai ortak do të konsiderohet se ka hequr dorë në mënyrë të përvokueshme nga e drejta për nënshkrimin e pjesës së tij në rritjen e kapitalit, dhe ortakët e tjerë do të kenë të drejtën të nënshkruajnë dhe të paguajnë këtë pjesë të rritjes së kapitalit themeltar në proporcion me kuotën e zotëruar, brenda dhe jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga njoftimi i dërguar nga Administratori/ët e Shoqërisë tek këta ortakë.

#### **Neni 8 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar**

- 8.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufirin e parashikuar nga ligji.
- 8.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me kuotën e zotëruar prej tyre në kapitalin e Shoqërisë.

#### **Neni 9 – Transferimi i kuotave**

- 9.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 9.2 Transferimi i kuotave të Shoqërisë në kuptimin më të gjerë të fjalës, me apo pa shpërblim, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të të tretëve, i nënshtrohet të drejtës së parablerjes.
- 9.3 Në rast se ortaku i Shoqërisë ("Ofertuesi") dëshiron të transferojë, një pjesë ose të gjithë kuotën e zotëruar prej tij, gjatë 5 (pese) viteve të para nga themelimi i Shoqërisë, duhet t'ia ofrojë kuotën në fjalë ortakëve të tjerë të Shoqërisë me vlerën nominale të kuotes.
- 9.4 Ofertuesi do t'ia ofrojë fillimisht kuotën që dëshiron të transferojë tek ortaku tjetër, sipas rastit ("Përfituesi") Ofertuesi duhet të njoftojë Përfituesin ("Njoftimi i Ofertës") duke i komunikuar (i) kuotën që do të ofrohet ("Kuota e Ofruar"); (ii) afatet dhe kushtet e shitjes së ofruar; (iii) datën në të cilën Përfituesi duhet të pranojë ofertën, datë e cila duhet të jetë jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga data në Njoftimin e Ofertës ("Data e Pranimit"); dhe (iv) datën e fundit për blerjen e kuotës, datë e cila duhet të jetë jo më shumë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e Njoftimit të Ofertës.
- 9.5 Përfituesi do të ketë të drejtën paraprake të blerjes dhe opsionin për të blerë Kuotën e Ofruar duke dorëzuar një njoftim pranimi të përvokueshëm ("Njoftimi i Pranimit") tek Ofertuesi në datën apo para Datës së Pranimit. Mbyllja e blerjes dhe shitjes do të zhvillohet në datën e përcaktuar në Njoftimin e Ofertës.
- 9.6 Nëse ndodh ndonjë nga ngjarjet e mëposhtme:
- (i) Përfituesi nuk e pranon Njoftimin e Ofertës ose Ofertuesi nuk ka marrë një Njoftim Pranimi brenda Datës së Pranimit;
  - (ii) pas lëshimit të Njoftimit të Pranimit, Përfituesi nuk arrin të blejë dhe paguajë për Kuotën e Ofruar në datën dhe vendin e specifikuar në Njoftimin e Ofertës për çfarëdo arsye jo për shkak të fajit të Ofertuesit;



atëherë Ofertuesi do të jetë i lirë të shesë Kuotën e Ofruar tek palë të treta sipas diskrecionit të tij.

### KAPITULLI III ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

#### Neni 10 – Asambleja e Përgjithshme dhe kompetencat e saj

- 10.1 Organi më i lartë vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme.
- 10.2 Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese:
- ndryshime ose shtesa të Statutit të Shoqërisë;
  - emërimin, shpërblimin, zëvendësimin dhe shkarkimin e administratorëve, ekspertëve kontabël dhe likuidatorëve;
  - rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar;
  - miratimin e transferimit të kuotave;
  - vendosjen e ndonjë barre mbi ndonjë kuotë;
  - çdo vendim për të miratuar ose shpërndarë një dividend, ose çdo shlyerje kuote, ndarje kuote ose dividendi të ortakëve;
  - shpërblimin e administratorit të Shoqërisë;
  - zbatimin e çdo vendimi që miraton çdo marrëveshje huaje dhe garanci;
  - ndryshimin në lidhje me të drejtat nënshkruese për detyrimet e Shoqërisë;
  - të drejtën për të transferuar çdo pjesë të aseteve të Shoqërisë;
  - çdo vendim për të krijuar, blerë, shitur ose zotëruar ndonjë shoqëri të kontrolluar nga Shoqëria;
  - miratimin e çdo vendimi që përbën një ndryshim thelbësor në natyrën e biznesit të Shoqërisë;
  - çdo vendim për të transformuar, bashkuar, shkëputur, ndarë, prishur, ose likuiduar Shoqërinë ose për ta riorganizuar atë në një formë tjetër;
  - miratimin e pasqyrave financiare vjetore;
  - krijimin e shoqërive, regjistrimin dhe blerjen e kuotave / aksioneve në kapitalin e shoqërive të tjera, qoftë në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj;
  - çdo çështje tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, Statuti dhe marrëveshjet e ortakëve (nëse ka ndonjë).

#### Neni 11 – E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 11.1 çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në Asamble e Përgjithshme, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është kuota që ai zotëron në kapitalin themeltar të Shoqërisë.
- 11.2 çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër i pajisur me prokurë me shkrim, i cili jo domosdoshmërisht duhet të jetë ortak. Në çdo rast, prokura me shkrim do të jetë e vlefshme për një Asamble të Përgjithshme, si për thirrjen e parë ashtu edhe për thirrjen e dytë të saj.

#### Neni 12 – Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi dhe vendimet

12.1 Asambleja e Përgjithshme thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e inventarit dhe bilancit, të raportit të Administratori/ët, si dhe raportit të ekspertit kontabël (nëse është emëruar). Për më tepër, Asambleja e Përgjithshme do të mbledhet në çdo kohë kur kërkohet nga legjislacioni në fuqi ose nga Statuti i Shoqërisë dhe çdo herë që kjo mbledhje është e nevojshme për të mbrojtur interesat e Shoqërisë.

12.2 Asambleja Përgjithshme thirret nga Administratori/ët ose prej ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja Përgjithshme duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me email ose me postë që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën e emailit ose adresën që ata i kanë njoftuar Shoqërisë, të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë Përgjithshme,



çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

12.3 Asambleja Përgjithshme mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, në Shqipëri apo jashtë saj.

12.4 Asambleja e Përgjithshme mund të mbahet edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës (përfshirë por pa u kufizuar me Teams, Zoom, Skype, WhatsApp, Viber ose çdo platformë tjetër komunikimi), me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen nga kryetari dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të marrin pjesë aktivisht në të; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja e Përgjithshme konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet njëkohësisht Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes.

Asambleja e Përgjithshme do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar, dhe nëse ata janë dakord të marrin vendime pavarësisht parregullsisë së njoftimit.

12.6 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat është e nevojshme një shumicë e zakonshme, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë më shumë se 50% (tridhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme, për të cilat është e nevojshme një shumicë e cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Në mungesë të kuorumit, asnjë çështje nuk do të trajtohet në mbledhje, dhe Asambleja e Përgjithshme do të shtyhet edhe për shtatë (7) ditë kalendarike; në vijim të saj, Mbledhja e Përgjithshme do të mbledhet përsëri në të njëjtin vend dhe në të njëjtën mënyrë si për Mbledhjen e Përgjithshme të Ortakëve, fillimisht të planifikuar.

12.7 Asambleja e Përgjithshme vendos përcështjet sipas paragrafit (a), (c), (f) dhe (m) të nenit 9.2. më sipër, me votën pro të të paktën 66% (gjashtëdhjetë e gjashtë përqind) të kapitalit të ortakëve pjesëmarrësve. Në të gjitha rastet e tjera dhe kur nuk është përcaktuar ndryshe në Statut, Asambleja e Përgjithshme merr vendim me votën pro të shumicës së kapitalit të ortakëve të pranishëm.

12.8 Asambleja e Përgjithshme drejtohet nga Kryetari i caktuar ndërmjet ortakëve ose personave të tjerë të pranishëm. Asambleja e Përgjithshme emëron një Sekretar, i cili mban procesverbalin dhe që mund të jetë edhe jo-ortak.

12.9 Vendimet dhe procesverbalet e Asamblesë së Përgjithshme do të mbahen në gjuhën angleze dhe të gjitha dokumentat e materialet e shpërndara për këto mbledhje do të jenë në anglisht ose do të kenë bashkangjitur përkthimin anglisht.

### Neni 13 – Administratori/ët

13.1 Shoqëria administrohet nga një ose më shumë administratorë, të emëruar nga Asambleja e Përgjithshme për një afat deri në 5 (pesë) vite. Në përfundim të këtij afati, Administratori/ët mund të rizgjidhet/n.

13.2 Administratori/ët përfaqësojnë Shoqërinë ndaj palëve të treta dhe kanë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, përveç kompetencave që në bazë të Statutit ose ligjit i përkasin organeve të tjera të Shoqërisë.

13.3 Administratori/ët duhet të marrë miratim paraprak nga Asambleja e Përgjithshme për transaksione mbi 10.000 Euro.



### **Neni 13 – Eksperti kontabël i autorizuar**

13.1 Në rast se kërkohet nga ligji, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë do të kryhet nga eksperti kontabël i emëruar për një periudhë 1 (një) vjeçare me mundësinë për t'u rizgjedhur për një periudhë tjetër nga Asambleja e Përgjithshme.

13.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislati në fuqi.

## **KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE**

### **Neni 14 – Viti Financiar dhe Bilanci Vjetor**

- 14.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 14.2 Bilanci vjetor, llogaritë financiare, inventari, raporti i Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga Asambleja e Përgjithshme.
- 14.3 Dokumentat që lidhen me vitin financiar duhet të miratohen brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

### **Neni 15 – Fitimet**

- 15.1 Fitimet që rrjedhin nga bilanci vjetor pas zbritjes së të gjitha shumave që Asambleja e Përgjithshme ka vendosur të lërë mënjanë, u shpërndahen ortakeve në proporcion me kuotën e tyre.
- 15.2 Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë, për qëllime të posaçme, krijimin e rezervave të posaçme apo të jashtëzakonshme, ose mund të vendosë edhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, tërësisht apo pjesërisht.

## **Kapitulli V SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI**

### **Neni 16 – Shpërndarja**

- 16.1 Shoqëria mund të shpërndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
- 16.2 Shoqëria nuk shpërndahet në rast të paaftësisë për të vepruar, paaftësisë ligjore, vdekjes, likuidimit apo falimentimit të ortakëve.

### **Neni 17 – Likuidimi**

- 17.1 Në rast të prishjes, Shoqëria duhet të likuidohet.
- 17.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Përgjithshme emëron një ose disa likuidatorë, të cilët do të paraqesin raportin përfundimtar të likuidimit mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 17.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja e Përgjithshme merr vendim lidhur me bilancin përfundimtar, punën e kryer nga likuiduesi/ët dhe përfundimin e procesit të likuidimit.
- 17.4 Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori/ët do t'ia shpërndajnë asetet dhe fitimin që mbetet pas likuidimit ortakëve në proporcion me kuotën e zotëruar prej tyre.

## **Kapitulli VI TË TJERA**



### Neni 18 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

18.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, si edhe ato që mund të lindin midis ortakëve ose midis një apo disa ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

18.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ajo do t'i besohet Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm të Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### Neni 20 – Gjuha


Ky Statut është hartuar në 4 (katër) kopje në gjuhën Shqip.

### Neni 21 – Dispozita të Fundit


Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Statut, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar për Shoqëritë Tregtare.

### ORTAKET


\_\_\_\_\_  
Vartkes Piranjani

Vartkes Piranjani 

\_\_\_\_\_  
Mariol Karanxhe

Mariol Karanxhe 

\_\_\_\_\_  
Tedi Mara

Tedi Mara 



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER ANILA K. GJERMENI**



V2024050290099664234

**DATE 08/04/2024  
NR REP 1254**



**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 08/04/2024, para meje Notere ANILA K. GJERMENI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, NR.7, BLV"GJERGJ FISHTA", NR.4, u paraqit personalisht:

**NËNSHKRUES:**

Vartkes Piranjani, atësia Varuzhan, amësia Mirela, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë M Gjollësia P14 Shk41 Ap24; Nd. 1838; Ap. 010; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 16/05/1995, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 033201357 dhe nr. personal J50516050G , .

**NËNSHKRUES:**

Mariol Karanxhe, atësia Murat, amësia Raimonda, shtetas Shqiptar, lindur në Elbasan dhe banues në Tiranë, me adresë B Curri Shk10; Nd. 001; Njësia Administrative Nr. 5; Njësia Bashkiake Nr. 5; 1019; Tiranë, lindur më 25/09/1988, gjendja civile "i divorcuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034073075 dhe nr. personal I80925056V , .

**NËNSHKRUES:**

Tedi Mara, atësia Muharem, amësia Teuta, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me adresë S.Cico; Nd. 0; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 3; Njësia Bashkiake Nr. 3; 1005; Tiranë, lindur më 13/01/1994, gjendja civile "beqar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 038090522 dhe nr. personal J40113041C , .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noteres, "Aktin e Themelimit dhe Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Rentzo Sh.p.k.", bashkëlidhur.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenin 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTERE**

**ANILA K. GJERMENI**